



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEKO - 16-016-111**

Sa i përket tenderit për **“Furnizim, montimi dhe lëshimi në punë i klimave industriale”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.P “PRIMUS engineering”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. “Nazim Gafuri” nr.113, Prishtinë 100000

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+377 44 145 686

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Burim Baraku

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@primus-ks.com


(Adresa elektronike)

05.01.2017

(Data e parashtrimit të ankesës)

Burim Baraku

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratësç:

- Me datën 27/06/2016 është bërë publikimi në web faqen e KRPP Njoftimi për kontratë, ndërsa afati i fundit për dorëzim të ofertës është datë 11/08/2016 Koha 12:00
- Koha e hapjes së ofertave më 11/08/2016 koha 12:30
- Me datën 06/10/2016 në web faqen e KRPP është publikuar Njoftimi për dhënjën e kontratës.
- Me datën 06/09/2016 kemi pranuar nëpërmjet emailit Letër Standarde për tenderuesin e pasukseshëm.
- Më datën 07/09/2016 na është mundësuar qasje në dokumentacionin zyrtar të prokurimit me nr. KEKO 16/016/111
- Më datën 10/10/2016 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim të dosjes së tenderit në AK
- Më datën 13/10/2016 kemi pranuar njoftimin negativ nga AK
- Më datën 20/10/2016 kemi bërë ankesën në OSHP
- Më datën 30/11/2016 kemi pranuar njoftimin nga OSHP për Ri-vlerësim të dosjes së tenderit.
- Më datën 23/12/2016 kemi pranuar vendimin nga AK se jemi eliminuar.
- Më datën 28/12/2016 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit në AK
- Më datën 30/12/2016 kemi pranuar vendim refuzimin nga AK
- Kriteri për dhënie të kontratës është: Çmimi më i Ulët i përgjegjshëm

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo

☐

Ecuria e hapjes së tenderit në rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 72 paragrafi 2 i ligjit LPP
Neni 28 paragrafi 4, 5, 6 dhe 9 ligjit LPP
Neni 59 paragrafi 4 i ligjit LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

-Bazuar në supozimet tona për shkelje të dispozitave të LPP-së të lartë cekura, më tutje deklarojmë me fakte mbi secilin paragraf si në vijim:

1. Më datën 28.12.2016 kemi dorëzuar në arkivën e zyrës KEK kërkesën për rishqyrtim të dosjes së tenderit me nr. prokurimit KEKO 16-016-11 e protokoluar me nr. 2719 datë 28.12.2016, në po të njëjtën datë kemi njoftuar me postë elektronike AK-në se kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim.

AK në vendimin e saj potencon se ka pranuar kërkesën për rishqyrtim përmes formës elektronike.

Gjë e cila nuk është e vërtetë, pasi që ne përmes postës elektronike vetëm e kemi njoftuar se kemi dorëzuar kërkesën tonë për rishqyrtim në zyret e arkivës KEK.

2. Duke u mbështetur tek neni 72 paragrafi 2 i LPP autoriteti kontraktues nuk na ka ftuar të qartësojmë dokumentacionin e paraqitur në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Pra AK nuk ka shprehur vullnetin profesional për të qartësuar produktin me nr. rendor 4, Model: V2DI 60 në lidhje me air flow e paisjes.

Ne edhe pse kemi kërkuar sqarim nga AK, nuk kemi marr përgjigje për arsyen e mos ftuarjes për sqarim të produktit para vendimit të tyre.

3. Duke u mbështetur në nenin 28 paragrafi 4, 5, 6 dhe 9 ligjit LPP të Rep. së Kosovës, Ku citohet se Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian, (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston.

Atëherë një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për refuzimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është në përputhshmëri me një specifikim të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni, nëse specifikimi i tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutuese ose funksionale dhe është i përshtatshëm. Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrë më të përshtatshme (siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimit nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me specifikimet e lartpërmendura gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale të autoritetit kontraktues.

Në bazë të kësaj si dëshmi ju sjellim:

-Deklaratën nga servisi i autorizuar N.T.P **“PRIMUS engineering”** për modelin V2DI 60

-Deklaratën nga prodhuesi **“Inventor A.G.ELECTRIC APPLIANCES S.A”** për modelin V2DI 60

-Kërkesën drejtuar **“Institutit të Universitetit të Fakultetit të Inxhinierisë Makinerike Prishtinë”** për shqyrtim të karakteristikave teknike të modelit V2DI 60

-Deklaratën nga pala e tretë e pavarur **“Institutit të Universitetit të Fakultetit të Makinerisë Prishtinë”** për analizën profesionale bërë modelit V2DI 60

4. Duke u mbështetur në nenin 59 paragrafi 4 citim:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:

(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Air kondicioneri V2DI 60 i plotëson të gjitha kushtet teknike të parapara në dosjen e tenderit, produkti në fjalë përmban vetëm një devijim të vogël në të mirë të AK-së, pasi që paisja në fjalë mund të komandohet në tri shpejtesi 3000/2500/2000 m³/h nga personeli i AK-së me ndihmën e pultit komandues (teledirigjuesi) sipas nevojës dhe arritja e temperaturës në ftohje/ngrohje në ambientin punues arrihet më shpejtë nëse paisja punon në shpejtësin më të madhe.

5. AK në vendimin për refuzim të dosjes së tenderit ka potencuar si arsyetim

Citim:

OE **“PRIMUS engineering”** ka pranuar atë çka ka ofruar mirëpo është përpjekur që të na jep **variante të cilat nuk pranohen**.

OE nuk ka ofruar **prova dhe fakte** të mjaftueshme për të ndryshuar vendimin e AK-së.

Fillimisht ne **“PRIMUS engineering”** nuk kemi ofruar **as një variant të ri** për produktin në fjalë.

Ne kemi dëshmuar me fakte dhe prova (katalogu dhe përshkrime teknik) si dhe analizën profesionale nga pala e tretë e pavarur (Instituti i Fakultetit të Inxhinierisë Makinerike Prishtinë) se air kondicioneri në fjalë i ka tri shpejtësi 3000/2500/2000 m³/h.

Ndryshimi i shpejtësive të air kondicionerit mund të bëhet me ndihmën e pultit komandues (teledirigjuesit) të cilën paisja e posedon dhe mund të kontrollohet nga personeli në çdo moment.

Shpejtësia e dytë prej 2500m³/h plotëson kërkesën i **barasvlershëm dhe ekuivalent** të AK-së për air flow 2300±10%.

Shpejtësia e parë dhe shpejtësia e tretë mund të përdoret sipas nevojës dhe kjo është në të mirë të AK-së.

Nëse shpejtësia e parë dhe shpejtësia e tretë janë të pa nevojshme ne mund ti eliminojmë dy shpejtësit e AC-së pa ndryshuar tipin, modelin, madhësinë dhe karakteristikat teknike të produktit me nr. rendor 4 (V2DI 60).

Pra të gjitha karakteristikat teknike të AC-së do të ruhen konform standardeve Ndërkombëtare dhe Evropiane.

Rikapitulim

1. Air kondicioneri model V2DI 60 i plotëson të gjitha standardet konform rregullave të Bashkimit Evropian dhe Ndërkombëtar.

Këtë e dëshmojnë edhe certifikatat konform standardeve evropiane siq janë standardi për kualitet ISO 9001:2000, EN ISO 9001:2000, BS EN ISO 9001:2000 dhe ISO 9001:2008 të bashkangjitura në dosjen e tenderit.

2. Air kondicioneri model V2DI 60 i ka tri shpejtësi 3000/2500/2000 m³/h
3. Shpejtësia e dytë 2500m³/h e plotëson kushtin **barasvlershëm dhe ekuivalent** e kërkuar nga AK për air flow 2300±10%.
4. Ndryshimi i shpejtësive të air kondicionerit V2DI 60 mund të bëhet me ndihmën e pultit komandues (teledirigjuesit) nga personeli në çdo moment.
5. Shërbimi i servisit të autorizuar N.T.P “PRIMUS engineering” mund të intervenojë në air kondicionerin në fjalë duke e eliminuar shpejtësinë e tretë 3000m³/h dhe të lë në funksion shpejtësinë e dytë=2500m³/h dhe shpejtësinë e parë = 2000m³/h pa ndryshuar as edhe një parametër tjetër të air kondicionerit. (deklarata e dorëzuar 1)
6. Prodhuesi “Inventor A.G.ELECTRIC APPLIANCES S.A.” në fabrikë gjatë prodhimit mund të zvogëloj kapacitetin e air flow nga 3000m³/h max në 2500m³/h max apo edhe më të vogël në 2000 m³/h me ndihmën e softwerit të integruar që e posedon air kondicioneri në fjalë, duke i ruajtur të gjitha karakteristikat teknike konform rregullave të EU-së.(deklarata e dorëzuar 2)
7. Instituti i pavarur i Universitetit të Fakultetit të Makinerisë në Prishtinë deklaron dhe vërteton se air kondicioneri ka tri shpejtësi 3000/2500/2000 m³/h, Kjo nënkupton se paisja në fjalë **punon me tri shpejtësi** dhe se ajo maksimale është me 3.000 m³/h ndërsa ajo minimale 2.000 m³/h. Mundësia e ndryshimit të sasisë së ajrit ekziston me pultin komandues (teledirigjuesi) në çdo moment nga personeli.
Mundësia e punës në shpejtësinë e madhe nënkupton që arritja e temperaturës së dëshiruar në ambientin punues është më e shpejtë, **në rast se kjo është e nevojshme.**
Sasia më e madhe e ajrit nuk ka kurrfarë ndikimi negativ tek paisjet të cilat kanë nevojë për ftohje/ngrohje (deklarata e dorëzuar 3)

Ne ju falenderojmë paraprakisht duke shpresuar për një trajtim korrekt dhe profesional në përputhje me ligjet e prokurimit publik të Rep. së Kosovës.

Për çdo çështje në lidhje me këtë ankesë mund të na kontaktoni në numrin 044/145-686

Me respekt,
N.T.P. “PRIMUS engineering”

Burim Baraku



9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*